



Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave
Komunale
Rr. Bulevardi Zogu I, Godina ZP Kati II-të, Tiranë
Tiranë – Shqipëri
Website: www.forest-al.org

Tiranë, 8 Qershor 2015

MEMO

DREJTUAR: Z. EDUARD SHALSI

KOMISIONI PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

TIRANË

Nga: FEDERATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE

Lënda: Për reformën në pyje dhe projekt ligjin "Për Pyjet dhe Kullotat në Republikën e Shqipërisë"

I nderuar z. EDUARD,

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, përfaqësuese e 251 Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHPPKK) dhe 11 Federatave Rajonale, e preokupuar për gjendjen shqetësuese në sektorin e pyjeve, ka zhvilluar disa takime në shkallë rajonale (në Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Kukës, Dibër dhe Divjakë), si dhe në nivel kombëtar. Në këto takime kanë marrë pjesë fshatarë përdorues tradicionalë të pyjeve të fshatit, përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, të drejtorive të shërbimit pyjor, të Ministrisë së Mjedisit, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Fondacionit “Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerëzit” (CNVP), deputetë të Kuvendit, nga Delegacioni Evropian në Shqipëri, Ambasada Suedeze (SIDA), Fakulteti i Shkencave Pyjore, biznesmenë dhe nga shoqëria civile.

Në këto takime është diskutuar për gjendjen në sektorin e pyjeve, për reformën dhe projektligjin e ri për pyjet dhe kullotat. Përfundimet e takimeve i kemi bërë prezent në media dhe në Ministri, por shohim me shqetësim të madh se gjendja e sektorit vazhdon të përkeqësohet.

Në vazhdim, paraqesim problemet kryesore shqetësuese dhe zgjidhjet e mundshme.

- Gjatë viteve të fundit, rreth 47% e fondit pyjor, përgjithësisht shkurre e pyje të degraduar në afërsi të fshatrave, janë transferuar në pronësi të njësive të qeverisjes vendore (NJQV), sidomos për përdorim nga fshati dhe familjet fshatare. Në 251NJQV janë ngritur shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave komunale (SHPPKK), të mbështetura nga projektet e Bankës Botërore, USAID, SNVP, Sida dhe ILC. Por, procesi i transferimit, nuk u shoqërua me kalimin përkatësisht të mjeteve, pajisjeve, fondeve, bazës dokumentare, personelit etj. Ende procesi është në mes të rrugës pasi prona pyjore nuk ka vajtur deri tek përdoruesi tradicional (fshati, familja), ata nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e tyre ekskluzive të përdorimit dhe nuk kanë të drejtë të shesin prodhime pyjore për të siguruar të ardhura.

- Me riorganizimet në kuadrin e “reformës” nga ana e Ministrisë, mund të themi se sektori pyjor është shthurur plotësisht. Janë pushuar në masë nga puna specialistë pyjesh me përvojë shumëvjeçare në sektorin e pyjeve dhe janë zëvendësuar me militantë partiakë pa kurrfarë arsimi pyjor. Kështu, drejtorët rajonalë të shërbimit pyjor, më shumë se gjysma e punonjësve të menaxhimit të pyjeve dhe mbi 100 nëpunës të inspektoratit të policisë pyjore të punësuar muajt e fundit janë pa arsim pyjor, përfshirë këtu mjekë, mësues muzike apo fizikulture etj.
- Vazhdon masakra në pyje dhe kontrabanda e organizuar. Ngjarja e fundit është e para disa ditëve në zonën e Librazhdit, ku u rrezikuan me jetë nga kontrabandistët tre inxhinierë pyjesh dhe dy operatorë televizioni që guxuan të filmonin pyllin e masakruar. Sipërfaqja e pyjeve dhe vëllimi drusor i tyre është pakësuar në mënyrë të ndjeshme, krahas ndikimeve të rënda mbi mjedisin.
- Në projektligjin e ri të përgatitur për pyjet, i hartuar në rrugë jotransparente, pa analiza të gjendjes, pa platformë të miratuar dhe pa pjesëmarrjen e duhur të palëve, dhe që po rri prej kohësh nëpër sirtare, nuk janë pasqyruar disa sugjerime thelbësore të dala nga konsultat e bëra për zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi pyjet, për varësinë e sektorit të pyjeve, të drejtat e përdoruesve tradicionalë të pyjeve e kullotave etj.
- Specialistët janë të shqetësuar edhe për efektivitetin e projekteve dhe fondeve të mëdha që harxhohen për pyjet pa studime serioze kompetente dhe pa konsultime me specialistët përkatës.
- Në Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit 2015-2020, në pjesën për pyjet, nuk ka asgjë konkrete, por është thjesht një përkthim joprofesional që nuk shërben për gjë.

Me gjithë rëndesën e problemeve të përmendura më lart, ekzistojnë premisat dhe mundësitë për rehabilitimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të pyjeve: Shërbimi pyjor ka përvoja të vlefshme për ruajtjen dhe shtimin e pyjeve; mjaft fshatra e familje kanë tradita për ruajtjen dhe qeverisjen e pyjeve (në to nuk ka as prerje kontrabandë, as zjarre, sikurse ndodh në pyjet shtetërore).

Propozojmë disa zgjidhje të mundshme, në përshtatje dhe me ndarjen e re territoriale administrative:

1. Sektori i pyjeve dhe kullotave të rikthehet në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, ku të krijohet e funksionojë Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe e Kullotave, si strukturë më vete në varësi të Ministrit. Kjo, sepse toka bujqësore, pylli dhe kullota kanë qenë gjithnjë së bashku baza e kushteve për jetesë të fshatarit tonë, si dhe për një bashkërendim e qeverisje më të mirë të pasurive natyrore.
2. Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të vendit të ndahet për çdo bashki sipas kufijve territoriale dhe në çdo bashki të krijohet drejtori e shërbimit pyjor (DSHP) me dy njësi: a) për pyjet e kullotat shtetërore dhe b) për pyjet e kullotat e fshatit dhe ata private. Aktiviteti i DSHP-së brenda sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave të bashkisë të ndahet në sektorë e zona pyjore me specialistët e pyjeve përkatës, sipas ngarkesës së normuar të sipërfaqes.
3. Bashkitë, në bashkëpunim me DSHP-të të rishikojnë kalimin e pyjeve dhe kullotave në përdorim të fshatit (për përdorim të përbashkët dhe të familjeve sipas traditës) për të kaluar edhe pyje të tjerë që i nevojiten fshatit, përfshirë gështenjat. Këshillohet të mbeten shtetërore: parqet kombëtare, brezi pyjor fushëmbrojtës bregdetar nga Vlora në Velipojë, pyjet mbrojtës të

pellgjeve ujëmbledhës të hidrocentraleve, pyjet mbrojtës të tokës anës lumenjve, liqeneve, ata anës rrugëve automobilistike e hekurudhore, si dhe çdo pyll tjetër që gjykohet me rëndësi të veçantë.

4. Ngastrat e pyjeve dhe kullotave të fshatit t'i jepen zyrtarisht në përdorim përdoruesit (fshatit, familjes rurale), duke zbatuar të drejtën tradicionale zakonore dhe të regjistronen në ZRPP; shpenzimet të përballohen nga shteti.

5. Përdoruesit tradicionalë (fshati, familja rurale) të kenë të drejta ekskluzive përdorimi mbi pyjet dhe kullotat e dhëna në përdorim, të kenë të drejtë të shfrytëzojnë e shesin prodhimet drusore e jodrusore që rezultojnë nga pylli e kullota e dhënë në përdorim (sipas planit të mbarështrimit të miratuar), si dhe nga pyjet e kullotat shtetërore që u jepen për shfrytëzim sipas kritereve e rregullave të caktuara, kundrejt një tarife të caktuar nga bashkia ose pa tarifë për familjet e varfra, për zbutjen e varfërisë dhe shtimin e të ardhurave, sidomos në zonat e varfra rurale.

6. Për përdoruesit tradicionalë (fshat, familje rurale), kur shihet se i ruajnë dhe i mbarështrajnë si duhet pyjet e veta, t'u bëhet kalimi nga përdorimi në pronësi, sipas kritereve të caktuara. Po ashtu, fshati me ligj të ketë pronat e veta publike (pyjet, kullotat, burimet e ujit, përrenjtë, guri, rëra e zhavorri, peshku etj.).

7. Shoqatat e përdoruesve të pyjeve e kullotave dhe federatat e tyre të mbështeten teknikisht e financiarisht nga shteti për kualifikimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështrimit të qëndrueshëm të pyjeve e kullotave në përdorim.

8. Propozohet të rikrijohet Instituti i Kërkimeve Pyjore, pasi nuk mund të ketë zhvillim pa studime e punë kërkimore shkencore.

9. Është urgjente të planifikohet dhe të kryhet inventarizimi i ri i pyjeve, ku të pasqyrohet gjendja reale dhe të përcaktohen masat për zhvillimin e mëtejshëm e të qëndrueshëm të tyre.

10. Projektligji i ri për pyjet e kullotat të ripunohet tërësisht në përputhje me ndryshimet territoriale, ku të pasqyrohen propozimet e bëra më lart, me rolet, përgjegjësitë dhe kompetenca të qarta për mbarështrimin e pyjeve shtetërore, të pyjeve të fshatit dhe atyre private.

Federata Kombëtare e PKK është e angazhuar të japë mbështetje maksimale për zbatimin e reformave të nevojshme në sektorin e pyjeve dhe kullotave, afrimin e tyre sa më pranë përdoruesve, me synim rritjen e mirëqenies sidomos në zonat e varfra rurale, si dhe mbrojtjen më të mirë të mjedisit në vendin tonë, në vijë me objektivin për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Me respekt, FKPKK